



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rregullore e Institutit për zhvillimin e karrierës e Kolegjit BIZNESI” është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, Statutin e Kolegjit neni 81, në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor i datës 25/09/2020, miraton:

INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS (IZHK),

Neni 1

Instituti për zhvillimin e karrierës (IZHK), është institucion që mundëson qasjen në trajnime dhe përkushtim në ndërtim të karrierës së personelit akademik, si dhe studentëve.

Neni 2

Instituti për zhvillimin e karrierës ka hartuar udhëzuesin për trajnime dhe qasje në karriere profesionale dhe ndërtim të kapaciteteve akademike.

Neni 3

Instituti për zhvillimin e karrierës bashkëpunon me institucionet tjera homologe dhe ndërton programe të përbashkëta avancuese në fushën e hulumtimit dhe të karrierës.

Neni 4

Instituti për zhvillimin e karrierës harton planin dy vjeçar për zhvillimin e stafit profesional.

Neni 5

Instituti për zhvillimin e karrierës ofron doracak me profile të nevojshëm për ekonominë e tregut dhe ndihmon studentet dhe Klubin Alumni.

Neni 6

Instituti për zhvillimin e karrierës ofron materiale dhe broshura informuese për karrierë.

Neni 7

Instituti për zhvillimin e karrierës ka të ndarë buxhet për zhvillim të karrierës profesionale nga Kolegji Biznesi

Neni 8

Instituti për zhvillimin e karrierës ofron rekomandime për Dekanin KLMSH dhe departamentet tjera për studime në Kolegjin Biznesi

Neni 9

Instituti për zhvillimin e karrierës bashkëpunon me Klinikën Ligjore dhe Zyrën për Projekte, dhe zyrën për emergjenca si dhe me Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtare në hartimin e prioriteteve studimore.

Neni 10

Instituti për zhvillimin e karrierës bashkëpunon me institucionet relevante për zhvillimin e karrierës publike dhe private

Neni 11

Rregullorja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, me 24.09.2020

Kryetari i KLMSH i Kolegjit BIZNESI

Prof.Dr.Shyqeri Kabashi
